







MERR POZICION, GATI, NISU!

Ja disa gjëra që mund të bësh që të të ndihmojnë të bëhesh gati për Të Rejat ose Të Rinjtë. A mund të bësh katër radhazi?

 <p>Bëj një libërshenjues për shkrimet e tua të shenjta.</p>	<p>Bisedo me dikë që mund të jetë i/e shqetësuar që do të largohet nga Fillorja.</p>	 <p>Vare një shkrim të shenjtë që të pëlqen, në shtëpi.</p>	<p>Tregoja dëshminë tënde dikujt.</p>
<p>Kërkoji peshkopit ose presidentit të degës një kopje të broshurës <i>Për Forcën e Rinisë: Një Udhëzues për Bërjen e Zgjedhjeve</i>.</p>	 <p>Zbukuro një fletore që ta marrësh në klasë.</p>	<h2>Hapësirë Bosh</h2>	 <p>Shkruaj një pusullë falënderimi një mësuesi/eje të Fillores.</p>
 <p>Lexo pyetjet e intervistës për rekomandim tempulli.</p> <p>(Mund t'i gesh ato në faqen 37 të botimit të nëntorit 2022 të revistës <i>Miku</i>.)</p>	<p>Pyete dikë se si është klasa e Të Rinjve ose Të Rejave.</p>	<p>Kërkoji një shoku ose shoqeje të klasës të futet me ty në klasën e re.</p>	<p>Shkruaj se çfarë po pret me padurim nga klasa e Të Rejave ose Të Rinjve.</p>
<p>Tako një udhëheqëse të Të Rejave ose një udhëheqës të Të Rinjve.</p>	 <p>Shkruaj tri gjëra që dëshiron të mësosh tek Të Rinjtë ose Të Rejat.</p>	<p>Lexoji artikujt në revistën <i>Për Forcën e Rinisë</i>.</p>	 <p>Pyete udhëheqësin/en e ri/re rreth veprimtarive të klasës. Shkruaj ato në kalendarin tënd!</p>

ILLUSTRIMET NGA COLLEEN MADDEN

KALIMI TEK TË RINJTË DHE TË REJAT

A do të bëhesh 12 vjeç/e vitin tjetër? Ja disa gjëra për të cilat të emocionohesh!

Një Revistë e Re

Revista *Për Forcën e Rinisë* është si revista *Miku*, por për Të Rinjtë dhe Të Rejat. Ajo është plot me histori nga të rinjtë dhe të rejat nga e gjithë bota që e ndjekin Jezu Krishtin, njësoj si ti.

Një Udhëzues për Bërjen e Zgjedhjeve

Për Forcën e Rinisë: Një Udhëzues për Bërjen e Zgjedhjeve është një broshurë që mund të të ndihmojë të zgjedhësh të drejtën. Ajo ka pyetje dhe përgjigje për të të ndihmuar të ndjekësh Jezu Krishtin dhe të përgatitesh për të shkuar në tempull.



Më Shumë Veprimtari

Tek Të Rejat dhe Të Rinjtë mund të bësh veprimtari argëtuese me të rinjtë dhe të rejat e tjera në lagjen ose degën tënde. Mund të vazhdosh edhe të vendosësh synime për programin "Fëmijët dhe Rinia" për të mësuar gjëra të reja dhe për të punuar për talentet e tua.